

Shkurt - Mars 2011

gap

monitor

i vendimeve të Qeverisë së Kosovës

- Përmes Projektligjit për Buxhetin 2011, Qeveria kërkon të drejtën edhe për privatizimin e ndërmarrjeve publike;
- Miratohet Strategjia Legjislative 2011 me 148 projektligje;
- Miratohet PVPE 2011;
- Miratohen zgjatjet buxhetore për muajin mars;

Mandati i tretë i Qeverisë së Republikës së Kosovës filloi punën në janar 2008 dhe e përfundoi atë në janar 2011. Qeveria Thaçi gjatë kësaj periudhe mbajti 151 mbledhje të rregullta dhe mori 948 vendime (duke mos llogaritur vendimet që kanë të bëjnë për miratim të procesverbaleve).

Kuvendi i Kosovës mandatoi Qeverinë e re dhe Qeveria Thaçi 2 filloi punën më 23 shkurt 2011. Kjo përbërje qeveritare ka numër rekord të portofolieve ministrare. Koalicioni qeverisës përbëhet nga ministrat e PDK, AKR dhe minoriteteve. Qeveria e re ka në përbërje zëvendëskryeministrin, 19 ministra dhe 6 zëvendëskryeministra. Rritja e portofolieve ministrare bie ndesh me shumë vendime ekzekutive të Qeverisë së Kosovës gjatë viteve 2008-2009, të cilat kishin për synim reformimin e administratës publike dhe uljen e numrit të ministrive.

Gjatë muajve shkurt – mars 2011, Qeveria e Kosovës ka mbajtur shtatë mbledhje; një në muajin shkurt dhe pesë në muajin mars, ku janë marrë gjithsej 32 vendime. Gjatë këtyre dy muajve janë marrë një sërë vendimesh të rëndësishme. Është miratuar Projektbuxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2011, Raporti i Buxhetit për 2010, Strategjia Legjislative 2011, Plani i Veprimit për Partneritet Evropian 2011, Plani i Punës së Qeverisë për 2011, etj. Të gjitha këto vendime janë vendime të rëndësishme dhe, për shkak të vonesave në konstituimin e Qeverisë, janë edhe vendime të vonuara.

Ashtu sikurse në janar 2008 kur ka filluar mandati qeveritar, edhe në mandatin e Qeverisë Thaçi 2 numërimi i mbledhjeve të Qeverisë nuk ka vazhduar aty ku ka mbetur në mandatin e kaluar, por fillon nga numri një. Në këtë përmbledhje të vendimeve për GAP Monitor për muajt shkurt dhe mars do të gjeni raportet për mbledhjet nga 1 deri në 6.

Përmbajtja:

1. Përmes Projektligjit për Buxhetin 2011, Qeveria kërkon të drejtën edhe për privatizimin e ndërmarrjeve publike;
2. Miratohet Strategjia Legjislative 2011 me 148 projektligje;
3. Miratohet PVPE 2011;
4. Miratohen zgjatjet buxhetore për muajin mars;
5. Për të tretin vit radhazi Qeveria miraton Planin Vjetor të Punës;
6. Qeveria miraton Raportin Vjetor Financiar për Vitin 2010
7. Ndryshohet përbërja e Komisionit për privatizimin e Distribucionit dhe Furnizimit;
8. Miratohet Rregullorja për Departamentet për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave në kuadër të Ministrive;
9. Qeveria miratoi Planin e Veprimit për 10 prioritetet kyçe të Qeverisë së Kosovës në fushën e integritimit evropian;
10. PTK ndan edhe 40 milionë euro për buxhetin;
11. Ndryshohet përbërja e komisionit qeveritar për privatizimin e PTK-së;
12. MPJ pritet të ketë një agjendë lobuese për shtimin e njohjeve si dhe Strategjinë për Politikë të Jashtme 2011-2015;
13. Miratohet Raporti i Vlerësimit të Përshtatshmërisë së Sistemit të Financimit për Komuna në vitin 2010
14. Themelohet Njësia për Bashkëpunim Ndërkombëtar për zbatim të ligjit;
15. Kosova me 14 pika të rregullta kufitare;
16. Organizohet Epopeja e UÇK;
17. Ministri i Financave autorizohet që të bëjë transfere deri në 20 mijë euro;
18. Miratohet Udhëzimi Administrativ për Përcaktimin e Procedurave pas Bartjes së Përgjegjësisë të Shërbimeve Sociale dhe Familjare në nivel komunal;
19. Qeveria miraton Rregulloren, në mungesë të Ligjit për Qeverinë;
20. Ndryshohet dhe Plotësohet Ligji për Akreditim;
21. Ri-miratohet Projektligji për Gjendjen Civile dhe Projektligji për Shërbimet e Sigurisë Private
22. Ndryshohet dhe plotësohet Ligji për Tregtinë e Brendshme
23. Ndryshohet dhe Plotësohet Projektligji për Noterinë
24. Ndryshohet dhe plotësohet Ligji për Shoqëritë Tregtare



Përmes Projektligjit për Buxhetin 2011, Qeveria kërkon të drejtën edhe për privatizimin e ndërmarrjeve publike

Qeveria e Kosovës, me anë të Projektligjit për Buxhetin 2011, përveç që kërkon miratimin e ndarjeve buxhetore, ajo po kërkon që Projektligji për Buxhetin 2011 t'i jap të drejtën edhe të procedojë me privatizimin e ndërmarrjeve publike, pa pasur nevojë që për to të marrë pëlqimin e Kuvendit të Kosovës pas kësaj

Në mbledhjen e 4-të të Qeverisë së Kosovës, të mbajtur më 11 mars 2011, u miratua Projektligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011. Kriza politike që nisi me dorëheqjen e ish presidentit Sejdiu dhe pastaj procesi zgjedhor i cili zgjati më shumë se tre muaj e lanë Kosovën pa buxhet për vitin e ri fiskal edhe pse Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, gjegjësisht neni 24 i lejon institucionet përgjegjëse të alokojnë dhe shpenzojnë mjete të buxhetit paraprak. Po sipas këtij ligji dhe neni, afati i fundit për financimin e shpenzimeve buxhetore të çfarëdo lloji për vitin e ri fiskal është data 1 prill. Pas kësaj date asnjë pagesë e çfarëdo lloji nuk mund të ekzekutohet. Procedimi nga Qeveria të Projektligjit për Buxhetin tek Kuvendi pritet të shqyrtohet nga kjo e fundit me datën 25 mars. Pra ekziston afati optimal për miratimin e këtij dokumenti mjaft të rëndësishëm deri me datën 1 prill.

Vendimi i Kryeministrit në largim për rritjen pagave për të gjithë punonjësit në sektorin publik me 50%, 40% dhe 30%, ngarkoi për së tepërmi buxhetin për vitin 2011. Përveç kësaj ky vendim ishte në kundërshtim me marrëveshjen e nënshkruar me FMN-në, kur më 21 korrik 2010 Qeverisë së Kosovës iu pranua kërkesa për kredi të butë në kuadër të programit "Stand by" nga ana e FMN-së. Vlera e kësaj kredie ishte €108.9 milionë. Në kuadër të marrëveshjes në mes të FMN-së dhe Qeverisë, ishte arritur pajtimi që Qeveria e Kosovës do të duhej t'i plotësojë disa parakushte dhe pastaj përgjatë procesit 18 mujor sa parashihet të zgjasë ky program të plotësojë edhe disa kushte tjera. Ndër këto kushte janë edhe stabiliteti makrofiskal. Kjo nënkupton që Qeveria duhet t'i forcojë mekanizmat për shtimin e grumbullimit të tatimeve – që nënkupton forcimin e luftës kundër ekonomisë jo-formale si dhe në të

njëjtën kohë, mos rritjen e pagave të punonjësve që paguhën nga Buxheti i Kosovës më shumë se 7-8%. Megjithëse kohëve të fundit Qeveria ka intensifikuar përpjekjet për shtimin e inkasimit të tatimeve, por rritja e pagave siç është e cekur në marrëveshje nuk është respektuar.

Në Projektbuxhetin për 2011 për paga dhe mëditje janë paraparë të shpenzohen gjithsej €383 milionë apo 72 milionë më shumë se në vitin paraprak. Kjo rritje prej 72 milion euro, nuk përfshin madje as vendimet e Qeverisë për rritje pagash (vendimi 01/151 dhe vendimi 02/151 i 6 janarit 2011), ngase për një rritje të tillë pagash nevojiten 140 milion euro. Të kujtojmë se në bazë të Kornizës Afat-mesme të Shpenzimeve 2011-2013, për paga dhe mëditje në 2011 do të duhej tëshpenzoheshin €316 milionë apo €17 milionë më shumë se në vitin paraprak. Pra Projektligji për Buxhetin 2011 bie ndesh edhe me KASH-in 2011-2013.

Përndryshe, me këtë Projektligj është paraparë që të hyrat totale të jenë gjithsej €1.264 miliardë apo €138 milionë më shumë se në vitin paraprak. Ndërkaq, shpenzimet e përgjithshme për këtë vit pritet të jenë €1.434 miliardë apo €232 milionë më shumë se në vitin paraprak. Pra parashihet deficit buxhetor prej 170 milion eurosh. Për shpenzimet kapitale pritet të alokohen €572 milionë apo €117 milionë më shumë se në vitin e kaluar.

Pakënaqësitë e mëdha të artikuluar nga ana e shoqërisë civile, partive opozitare, FMN-së dhe institucioneve tjera kundrejt mënyrës së përpilimit të këtij dokumenti të rëndësishëm për shtetin, nuk janë marrë parasysh nga ana e Qeverisë. FMN ka shprehur qëndrimin kundër Projektbuxhetit 2011 në

formën që është miratuar në Qeveri dhe nëse edhe Kuvendi e miraton këtë buxhet, atëherë do të prishej marrëveshja "Stand-By" në mes të Kosovës dhe FMN-së. Në këtë rast Kosova do të humb 290 milion euro: 80 milion eurot e mbetura nga marrëveshja me FMN, 60 milion euro të premtuara nga BB dhe 150 milion euro të Komisionit Evropian. Këto mjete janë planifikuar si të hyra në shumën prej 167 milion euro në Projektbuxhetin 2011, çka nënkupton se në rast se këto organizata tërheqin premtimet e tyre për këto mjete, atëherë deficitin buxhetor do të jetë 337 milion euro.

Qeveria e Kosovës, me anë të Projektligjit për Buxhetin 2011, përveç që kërkon miratimin e ndarjeve buxhetore, ajo po kërkon që Projektligji për Buxhetin 2011 t'i jap të drejtën edhe të procedojë me privatizimin e ndërmarrjeve publike, pa pasur nevojë që për to të marrë pëlqimin e Kuvendit të Kosovës pas kësaj. Neni 4 i Projektligjit për Buxhetin 2011 specifikon që Strategjia për Privatizimin e PTK-së sh.a., në momentin e miratimit të këtij ligji, miratohet automatikisht gjithashtu. Pra, në momentin që ky projektligj miratohet nga Kuvendi dhe pastaj dekretohet edhe nga Presidenti, atëherë Qeveria e ka të drejtën që menjëherë të procedojë me shitjen e aksioneve të kësaj kompanie në përputhje me obligimet që rrjedhin nga Neni 9 i Ligjit për Ndërmarrjet Publike. Madje po ky nen, lë hapur që në këtë mënyrë të privatizohen edhe ndërmarrje tjera publike, siç është distribucioni apo burimet e energjisë, vetëm me vendime qeveritare.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKES SË KOSOVËS
OFFICIAL GAZETTE OF THE REPUBLIC OF KOSOVA
SLUŽBENI LIST REPUBLIKE KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ RESMİ GAZETESİ
SLUŽBENE NOVINE REPUBLIKE KOSOVA

Miratohet Strategjia Legjislative 2011 me 148 projektligje

Nëse shikojmë nivelin e zbatimit të strategjive legjislative që nga viti 2008, kuptojmë se Qeveria e Kosovës asnjëherë nuk ka mundur që të miratojë projektligjet, ashtu siç janë paraparë në Strategji Legjislative. Strategjia Legjislative e vitit 2008 ishte zbatuar në masën 76%, ajo e vitit 2009 është zbatuar 44.8%; kurse Strategjia Legjislative 2010 është zbatuar vetëm 41.9%

Këtë vit Qeveria ka vetëm nëntë muaj për të proceduar këto projektligje në Kuvend, ngase deri në fund të marsit 2011 vetëm një projektligj është proceduar në Kuvend: Projektligji për Buxhetin 2011

Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e saj të 5-të të mbajtur më 16 mars 2011, ka miratuar Strategjinë Legjislative për vitin 2011. Për shkak të procesit zgjedhor, kjo strategji u miratua në muajin mars, për dallim nga dy strategjitë e mëparshme (atë të 2009 dhe 2010) të cilat u miratuan në muajin dhjetor. Edhe me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Kosovës, neni 24.1, thuhet se në dhjetor të çdo viti kalendarik Qeveria miraton strategjinë legjislative që përmban projektligjet të cilat pritet të shqyrtohen në vitin pasardhës.

Strategjia Legjislative e Qeverisë është një nga dokumentet më të rëndësishme qeveritare dhe si e tillë shërben për të planifikuar punën në ekzekutiv dhe legjislativ. Strategjia legjislative 2011 në përmbajtjen e saj ka gjithsej 148 projektligje. Kjo është strategjia më voluminoze që është miratuar ndonjëherë. Numri më i madh i projektligjeve në Strategjinë Legjislative 2011 janë bartur nga strategjia e vitit të kaluar. Për shkak të shpërbërjes

së Kuvendit të Kosovës në fillim të nëntorit 2010, Qeveria nuk arriti që të miratojë projektligjet e parapara për nëntor dhe dhjetor. Kurse, sipas Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, projektligjet që kanë qenë në procedurë për t'u shqyrtuar gjatë legjislaturës së tretë dhe nuk janë miratuar, duhet që t'i kthehen Qeverisë.

Nëse shikojmë nivelin e zbatimit të strategjive legjislative që nga viti 2008, kuptojmë se Qeveria e Kosovës asnjëherë nuk ka mundur që të miratojë projektligjet ashtu siç janë paraparë në Strategji Legjislative. Strategjia Legjislative e vitit 2008 ishte zbatuar në masën 76%, ajo e vitit 2009 është zbatuar 44.8%; kurse Strategjia Legjislative 2010 është zbatuar vetëm 41.9%. Vështirë të besohet se Strategjia Legjislative 2011 do të mund të zbatohet mbi masën 50%. Tri vitet e kaluara kanë treguar se Kuvendi i Kosovës nuk mund të shqyrtojë më shumë se 30-40 projektligje në vit, kurse Qeveria e Kosovës nuk mund të procedojë më shumë se 57

projektligje (nëse përjashtojmë këtu vitin 2008, ku ligjet e parapara me Pako të Ahtisaarit janë miratuar me procedurë të përsheptuar dy ditore). Këtë vit Qeveria ka vetëm nëntë muaj për të proceduar këto projektligje në Kuvend, ngase deri në fund të marsit 2011 vetëm një projektligj është proceduar në Kuvend: Projektligji për Buxhetin 2011.

Duke vlerësuar strategjinë legislative si një dokument të rëndësishëm publik, si dhe duke parë që ky dokument ka mangësi në hartim dhe zbatim,

në 2010 GAP ka publikuar analizën “Fakte rreth Strategjisë Legislative – zbatimi dhe ndikimi në punën e Kuvendit dhe Qeverisë”, përmes së cilës kemi kërkuar që Qeveria të hartojë një strategji me më pak projektligje, Kuvendi të bëjë presion tek Qeveria që projektligjet me prioritet të lartë t’i procedojë me kohë në Kuvend, si dhe të ketë një bashkëpunim mes Qeverisë dhe Kuvendit lidhur me prioritizimin e strategjisë legislative.

Miratohet PVPE 2011

Since the end of the war in Kosovo (1998-1999), the draft law on missing persons is reviewed for the first time.

Qeveria e Republikës së Kosovës edhe këtë vit, në mbledhjen e saj të 5-të, miratoi Planin e Veprimit për Partneritet Evropian 2011. Duke pasur parasysh që Integrimi Evropian mbetet prioriteti kryesor i Qeverisë së Kosovës, ky Plan i Veprimit për Partneritet Evropian ka për qëllim adresimin e sfidave dhe prioritetëve kyçe afatshkurta dhe afatmesme të identifikuar nga Partneriteti Evropian 2008.

Në këtë plan parashihet përparimi i mëtutjeshëm i vendit, i cili do të matet në bazë të zbatimit të prioritetëve kyçe, afatshkurta dhe afatmesme, në kuadër të Partneritetit Evropian përmes Raportit vjetor të Progresit nga Komisioni Evropian. Andaj, PVPE-ja do të luajë një rol të rëndësishëm në planifikimin e veprimtarisë së përgjithshme të Qeverisë në lidhje me agjendën politike dhe prioritetet e saj, agjendën legislative të Qeverisë dhe të Kuvendit, nevojat për punësim, ndërtimin institucional dhe trajnimin e personelit si dhe investimet e nevojshme.

Ky plan do të ndjekë strukturën e Partneritetit Evropian për Kosovën 2008 si dhe është në pajtim me kriteret e Kopenhagës dhe Madridit dhe përmban tre kapituj kryesor: Kriteret Politike, Kriteret Ekonomike dhe Standardet Evropiane.

Edhe këtë vit numri i objektivave të PVPE-së është zvogëluar për dallim nga vitet e kaluara. PVPE 2008 identifikonte 1502 veprime, PVPE 2009 identifikonte 1598 veprime, PVPE 2010 identifikonte 1000 veprime, përderisa PVPE-ja 2011 ka gjithsej 400 veprime, prej tyre 60 veprime janë paraparë në fushën e kriterëve politike, 50 veprime në fushën

e kriterëve ekonomike dhe 290 për standardet evropiane.

Me qëllim që PVPE-ja të jetë një dokument më i matshëm dhe më praktik, këtë vit janë përcaktuar edhe indikatorët matës në nivel të veprimeve ku janë përcaktuar vetëm indikatorët e kontributit/inputit (veprimet dhe buxheti) dhe indikatorët e produktit/outputit, për të vazhduar në të ardhmen edhe me përcaktimin e indikatorëve për prioritetet, respektivisht indikatorët e rezultatit (outcome) dhe indikatorët e efekteve (impact).

Së fundi, kostoja e totale e PVPE 2011 është vlerësuar të jetë rreth 1 miliard e 285 milion euro, ku 920 milionë euro planifikohet të mbulohen nga BKK, 83 milionë euro planifikohet të mbulohen nga donatorët, ndërsa 282 milion është vlerësuar të jetë mungesa (zbrazëtira).

Partneriteti Evropian është një nga instrumentet e BE-së për të mbështetur reformat në vendet e Ballkanit Perëndimor. Ky është viti i pestë (pas atyre të 2006, 2008, 2009 dhe 2010), që Qeveria e miraton Planin e Veprimit për Partneritet Evropian 2011. Partneriteti Evropian publikohet një herë në dy vjet, ndërsa BE-ja deri më tani ka publikuar vetëm tri raporte të Partneritetit Evropian për Kosovën. Raporti i fundit është ai i vitit 2008.

Në qershor 2009, Instituti GAP, përmes një konference dhe analizës “Kriteret Ekonomike të Kopenhagës-çfarë duhet të bëjë Kosova”, pati kërkuar që PVPE të përmbajë më pak objektiva, që ato të jenë më përmbajtësore dhe të implementueshme.



Miratohen zgjatjet buxhetore për muajin mars

Asnjëherë më parë nuk ka ndodhur që Buxheti i Kosovës të mos aprovohet në Kuvend para datës 15 shkurt. Buxheti 2011 pritet të miratohet në muajin mars. Deri atëherë, Qeveria ka gjetur një zgjidhje të përkohshme duke miratuar dhe proceduar në Kuvend një buxhet të vazhduar vetëm për muajin mars.

Kriza politike dhe institucionale që u shkaktua pas dorëheqjes së presidentit Sejdiu dhe pastaj prolongimi i stërgjatur i procesit zgjedhor përgjatë muajit të fundit të vitit paraprak dhe në fillim të muajve të këtij viti, e la Kosovën pa buxhet. Nuk ishte e mundur që të procedohej nga Qeveria për në Kuvend të projektbuxhetit për vitin e ri fiskal pasi Kuvendi ishte i shpërbërë dhe KQZ ende nuk kishte certifikuar rezultatet e zgjedhjeve.

Sidoqoftë, edhe pse në një gjendje të tillë, Ligji për Menaxhimin e Financave Publike parasheh që në raste të tilla të pamundësisë së miratimit të buxhetit për vitin e ri fiskal, gjegjësisht neni 24 që ka të bëjë me ndarjet buxhetore në mungesë të një Ligji për Ndarjet Buxhetore, që nëse zgjedhjet e përgjithshme për deputetët e Kuvendit janë mbajtur më pak se katër muaj para fillimit të vitit përkatës

fiskal, kjo automatikisht garanton për dy muajt e parë të vitit të ri fiskal mbulimin e shpenzimeve nga ana e organizatave buxhetore që është i barabartë 16.67% të ndarjes buxhetore të siguruar për organizatën e tillë buxhetore nga ligji i ndarjeve buxhetore.

Ndërkaq, pasi që kaluan dy muaj të vitit të ri fiskal, dhe Kosova hyri në muajin e tretë pa buxhet dhe duke pas për bazë që tek më 22 shkurt Kuvendi votoi qeverinë e re, kësaj të fundit i duhej urgjentisht të përgatisë buxhetin për muajin mars dhe ta procedojë menjëherë në Kuvend. Kështu, menjëherë të nesërmen pas votimit nga ana e Kuvendit dhe konstituimit të kabinetit të ri qeveritar, kjo e fundit e mbajti mbledhjen e saj të parë, me datën 23 shkurt 2011, ku miratoi zgjatjen e ndarjeve buxhetore për muajin mars të vitit 2011 të

në Ligjin nr. 03/L-218, "Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-177 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010.

Këtë propozim të Qeverisë, Kuvendi e miratoi me 3 mars, në bazë të nenit 24.2 të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë ku thuhet që

vetëm Kuvendi, me anë të një vendimi, mund të autorizojë zgjatjen e Ligjit për Ndarjet Buxhetore të vitit të kaluar fiskal. Ligji për Ndarjet Buxhetore të vitit të kaluar fiskal, në asnjë rast, nuk mund të zgjatet për më shumë se tre muaj të vitit të ardhshëm fiskal

Për të tretin vit radhazi Qeveria miraton Planin Vjetor të Punës

Ky është viti i tretë me radhë që Qeveria e Kosovës aprovon plan të punës për tërë vitin.

Asnjëherë Qeveria e Kosovës nuk ka bërë ndonjë vlerësim se sa po zbatohet Plani i Punës, edhe pse në Planin e Punës për 2009 parashihej që një vlerësim i tillë të bëhej çdo tre muaj.

Ky plan përmban pikat kyçe të cilat Qeveria e Kosovës planifikon t'i konkretizojë me veprime përgjatë këtij viti.

Në mbledhjen e 5-të të Qeverisë së Kosovës, të mbajtur më 16 mars 2011, u miratua Plani i Punës së Qeverisë së Kosovës për vitin 2011. Ky plan përmban pikat kyçe të cilat Qeveria e Kosovës planifikon t'i konkretizojë me veprime përgjatë këtij viti. Poashtu, në këtë dokument janë të paraqitura edhe aktivitetet, afati kohor, ndikimi financiar,

ndërlidhja e këtyre veprimeve me Planin e Veprimit për Partneritet Evropian, etj.

Pikat kyçe janë kategorizuar në ministritë e linjës, duke përfshirë edhe Zyrën e Kryeministrit, të cilët kanë autorizim dhe mandat për t'i zbatuar.

Në vazhdim, po i paraqesim aktivitetet për arritjen e prioritetëve strategjike të Qeverisë:

1. Zhvillimi ekonomik

- 1.1. Zhvillimi i infrastrukturës në fushën e transportit
- 1.2. Furnizimi i qëndrueshëm me energji elektrike
- 1.3. Edukimi gjithëpërfshirës cilësor dhe në pajtim me nevojat e tregut
- 1.4. Luftimi i Ekonomisë Joformale
- 1.5. Marrëveshje për bashkëpunim ekonomik me vende rajonale dhe institucione ndërkombëtare
- 1.6. Përkrahja e sektorëve kyç me ndikim në zhvillimin ekonomik të vendit

2. Qeverisja e mirë

- 2.1. Sundimi i rendit dhe ligjit
- 2.2. Reforma e Administratës Publike
- 2.3. Lufta kundër Korrupsionit

3. Kohezioni Social

- 3.1. Përkrahja për kategoritë e veçanta të shoqërisë
- 3.2. Shëndetësi cilësor dhe me qasje për të gjithë

1. Zyra e Kryeministrit

- 1.1. Koordinimi dhe monitorimi i zbatimit të politikave dhe vendimmarrjes në Qeveri
 - 1.2. Planifikimi strategjik
 - 1.3. Bashkëpunimi rajonal
 - 1.4. Plotësimi i infrastrukturës ligjore nga fushëveprimi i ZKM
 - 1.5. Hartimi, zbatimi, promovimi dhe monitorimi i dokumenteve strategjike për të drejtat e njeriut
 - 1.6. Zbatimi i legjislationit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe përmirësimi i kushteve të jetesës së gjithë komuniteteve në mënyrë të barabartë
 - 1.7. Trajtimi çështjes së zgjidhjes së fatit të personave të pagjetur përmes bashkëpunimit me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë
 - 1.8. Transparenca dhe komunikimi me qytetarë
-

2. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

- 2.1. Të sigurohet qasje gjithëpërfshirëse dhe e barabartë për të gjithë fëmijët në edukim cilësor dhe jodiskriminues deri në moshën 6 vjeçare
 - 2.2. Të sigurohet qasje gjithëpërfshirëse dhe e barabartë për të gjithë nxënësit në arsim të obliguar dhe inkurajimi i të nxënësve gjatë gjithë jetës
 - 2.3. Të përmirësohet qasja, cilësia dhe relevanca e AAP-së dhe përmirësimi i koordinimit të tij
 - 2.4. Të ndërtohet një sistem efektiv dhe i qëndrueshëm i zhvillimit të mësimdhënësve
 - 2.5. Hartimi dhe jetësimi i politikave dhe legjislationit për ndërtimin e një sistemi efikas dhe efektiv të menaxhimit të arsimit të lartë dhe për rritjen e kapaciteteve për kërkime shkencore
 - 2.6. Përkrahja dhe avancimi i procesit të të nxënësve për të gjithë, duke bërë integrimin efektiv të TIK-ut
-

3. Ministria e Integritimit Evropian

- 3.1. Menaxhimi i agjendës Evropiane në kuadër të Dialogut të Procesit të Stabilizim-Asociimit (DPSA)
 - 3.2. Koordinimi i strukturave qeveritare për Integritim Evropian
 - 3.3. Ngritja e kapaciteteve administrative në çështje evropiane, përfshirë procesin e komunikimit dhe informimit
 - 3.4. Koordinimi i asistencës financiare
 - 3.5. Përafrimi i legjislationit/koordinimi i përkthimit
-

4. Ministria e Drejtësisë

- 4.1. Krijimi i infrastrukturës ligjore në funksion të sundimit të rendit dhe ligjit në harmoni me standardet e BE-së
 - 4.2. Avancimi i ndihmës dhe bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në përputhje me përvojat më të mira evropiane
 - 4.3. Mbikëqyrja dhe administrimi efikas i sistemit për ekzekutimin e sanksioneve penale (Shërbimit Korrektues dhe Shërbimit Sprovues)
 - 4.4. Zhvillimi i një sistemi efikas për mbrojtjen e viktimave të dhunës familjare, trafikimit, si dhe gjetjen dhe identifikimin e personave të zhdukur gjatë luftës
 - 4.5. Zhvillimi i kapaciteteve profesionale për funksionim efikas të fushë veprimtarisë së Ministrisë së Drejtësisë.
-

5. Ministria e Zhvillimit Ekonomik

- 5.1. Ndërtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese dhe zhvillimi i mëtejshëm i sistemit të bartjes dhe shpërndarjes
 - 5.2. Përfundimi i reformave në sektorin energjetik në përputhje me obligimet e TKE-së
 - 5.3. Zhvillimi i burimeve të ripërtitshme të energjisë dhe përmirësimi i eficiencës së energjisë
 - 5.4. Ristrukturimi i sektorit mineral si dhe zgjidhja e çështjes mjedisore dhe sociale
 - 5.5. Përgatitja në ngritjen e investimeve
-

6. Ministria e Financave

- 6.1. Hartimi i Propozim Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2012/2013, si dhe fillimi realizmit të shpenzimeve të vitit financiar 2011
 - 6.2. Ngritja e nivelit të bashkëpunimit me institucionet financiare ndërkombëtare sidomos FMN, BB, Komisioni Evropian si dhe freskimi i raporteve që dalin në fushën e Integritetit Evropian
 - 6.3. Hartimi i projeksioneve dhe analizave ekonomike në funksion të dizajnit të politikave të qëndrueshme makro-fiskale. Realizimi i planit fiskal mbi të hyrat
 - 6.4. Menaxhimi efikas, transparent dhe i drejtë i financave publike në Kosovë
 - 6.5. Kompletimi i infrastrukturës ligjore në fushën ekonomike dhe financiare në harmoni me acquis communautaire
 - 6.6. Mbikëqyrja dhe monitorimi i aktiviteteve të auditimit të brendshëm në Sektorin Publik
-

7. Ministria e Forcës së Sigurisë

- 7.1. Të vazhdohet ngritja e FSK-së si forcë profesionale e sigurisë për të arritur kapacitetet e plota operacionale
 - 7.2. Të zhvillohen dhe të ofrohen strategji të personelit për MFSK-në dhe FSK-në për arritjen e kapaciteteve të plota dhe zhvillimi pas KPO-ve
 - 7.3. Të realizohen investimet kapitale sipas prioritetëve në infrastrukturë dhe në Programet për pajisje për arritjen e kapaciteteve të plota
 - 7.4. Ngritja dhe zhvillimi i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional, bilateral dhe rajonal
 - 7.5. Hartimi dhe aprovimi i Strategjisë për FSK-në dhe dokumentet ligjore si dhe zbatimi i tyre
-

8. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

- 8.1. Përmirësimi i gjendjes së mjedisit
 - 8.2. Menaxhimi i resurseve ujore
 - 8.3. Fuqizimi i planifikimit hapësinor, banimit dhe ndërtimit
 - 8.4. Ngritja dhe fuqizimi i Inspektoratit
 - 8.5. Administrimi i tokës dhe zhvillimi i kadastrit në Kosovë
-

9. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

- 9.1. Plotësimi i kuadrit ligjor në fushën e qeverisjes lokale
- 9.2. Monitorimi dhe mbikëqyrja e komunave
- 9.3. Reforma e Pushtetit Lokal
- 9.4. Promovimi i Zhvillimit Ekonomik lokal dhe Rajonal
- 9.5. Zhvillimi i kapaciteteve në administratën komunale

10. Ministria e Punëve të Brendshme

- 10.1. Përmbyllja e strategjisë legjislative
 - 10.2. Promovimi i politikave të migrimit legal dhe riatdhesimit
 - 10.3. Ngritja e sigurisë së të dhënave të gjendjes civile
 - 10.4. Menaxhimi i integruar i kufirit
 - 10.5. Ngritja e kapaciteteve
-

11. Ministria e Punëve të Jashtme

- 11.1. Intensifikimi dhe përsheptimi i procesit të njohjeve të shtetit të Kosovës
 - 11.2. Anëtarësimi i Republikës së Kosovës në organizatat politike dhe financiare ndërkombëtare dhe pjesëmarrja në nismat dhe forumet rajonale dhe ndërkombëtare
 - 11.3. Forcimi i marrëdhënieve dypalëshe dhe intensifikimi i lidhjes së marrëveshjeve ndërkombëtare
 - 11.4. Konsolidimi i mëtejme i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe i misionëve diplomatike dhe konsullore
 - 11.5. Promovimi i interesave ekonomike të Republikës së Kosovës në botë dhe tërheqja e investimeve të jashtme në vend
-

12. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

- 12.1. Ngritja e shkallës së punësimit dhe ngritja e aftësive profesionale e punëkërkuarve
 - 12.2. Implementimi i legjislacionit ekzistues nga fusha e shërbimeve dhe e ndihmës sociale për familjet në nevojë
 - 12.3. Krijimi i një sistemi pensional treshtyllësh, i drejtë, funksional, me burime të qëndrueshme financiare, i cili i plotëson kërkesat nga e drejta pensionale për të gjitha kategoritë e pensioneve
 - 12.4. Krijimi i legjislacionit primar dhe sekondar nga fusha e punësimit dhe çështjeve sociale, në përputhje me legjislacionin e BE-së
 - 12.5. Mbikëqyrja e dispozitave ligjore që rregullojnë lëmin e punës, punësimit, sigurisë në punë, mbrojtjen e shëndetit të të punësuarve dhe implementimi i ndryshimeve në legjislacionin e Shërbimit Civil të Kosovës
-

13. Ministria për Komunitete dhe Kthim

- 13.1. Projektet e ndërtimit të banesave dhe shtëpive për të kthyerit
 - 13.2. Projektet për zhvillimin e komuniteteve
 - 13.3. Sendërtimi i kornizës operacionale që i përgjigjet nevojave dhe kërkesave të PZHBV dhe të shpërngulurve
 - 13.4. Monitorimi proaktiv i kthimit, riintegrit, dialogut ndëretnik, stabilizimit të komunitetit dhe projekteve e programeve zhvillimore
 - 13.5. Implementimi i Strategjisë së Integrit dhe Riintegrit të Komuniteteve
-

14. Ministria e Shëndetësisë

- 14.1. Zvogëlimi i sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë së përgjithshme të popullatës
 - 14.2. Riorganizimi funksional dhe kompletimi i infrastrukturës ekzistuese
 - 14.3. Përmirësimi i menaxhimit të resurseve ekzistuese dhe cilësisë së shërbimeve
 - 14.4. Zhvillimi dhe implementimi i Sistemit Informues Shëndetësor
 - 14.5. Zhvillimi i sistemit të qëndrueshëm financiar të sektorit shëndetësor
-

15. Ministria e Administratës Publike

- 15.1. Qeverisja elektronike
 - 15.2. Sigurimi i politikave të inxhinieringut dhe menaxhimit të ndërtesave qeveritare
 - 15.3. Statistikat zyrtare
 - 15.4. Ngritja e aftësive dhe njohurive të nëpunësve civilë për t'i përmbushur në mënyrë efikase detyrat e tyre dhe ato të institucionit
 - 15.5. Legjislacioni në fushën e administratës publike
-

16. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

- 16.1. Mbështetja e institucioneve të kulturës dhe promovimi i veprimtarisë së tyre
 - 16.2. Ruajtja dhe promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore
 - 16.3. Infrastruktura dhe ndërkombëtarizimi i sportit
 - 16.4. Sigurimi i mekanizmave institucional për pjesëmarrjen e të rinjve në procesin e vendimmarrjes
 - 16.5. Zbatimi i PVPE
-

17. Ministria e Infrastrukturës

- 17.1. Përmirësimi, zhvillimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së transportit dhe infrastrukturës së komunikimeve elektronike brezgjera e cila është e integruar në korridoret Pan-Evropiane dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare
 - 17.2. Krijimi i ambientit të favorshëm dhe të sigurt rregullativ për maksimizimin dhe ngritjen e cilësisë së shërbimeve në fushën e transportit, komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare
 - 17.3. Strukturë funksionale me burime njerëzore të mjaftueshme mirë të motivuara dhe kompetente për sektorët e Transportit dhe Shoqërisë së Informacionit
-

18. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

- 18.1. Dizajnimi i politikave të favorshme zhvillimore për bujqësi dhe zhvillim rural
 - 18.2. Zhvillimi i mëtejshëm institucional
 - 18.3. Ofrimi i shërbimeve efikase profesionale për fermerë
 - 18.4. Kompletimi i infrastrukturës ligjore në harmoni me atë të BE-së
 - 18.5. Mbrojtja e tokës bujqësore dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i saj
 - 18.6. Menaxhimi i Qëndrueshëm i Pyjeve
 - 18.7. Avancimi i politikave sektoriale për menaxhimin e qëndrueshëm të resurseve pyjore, kafshëve të egra
 - 18.8. Siguria e ushqimit, ruajtja e shëndetit të njeriut dhe kafshëve, si dhe ruajtja e mjedisit jetësor
 - 18.9. Promovimi i të arriturave në sektorët e bujqësisë dhe blegtorisë
 - 18.10. Kompletimi i bazës ligjore me U/A
-

19. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

- 19.1. Regjistrimi i bizneseve dhe funksionimi i zyrës së pengut
 - 19.2. Zbatimi i politikave tregtare
 - 19.3. Implementimi i Strategjisë së Industrisë së Kosovës 2010 – 2013
 - 19.4. Regjistrimi i objekteve të pronës industriale
 - 19.5. Hartimi dhe Zhvillimi i Politikave Turistike
-

Duke përfshirë edhe këtë të fundit, deri më tani Qeveria e Kosovës ka miratuar 3 plane të tilla. Planin e parë i punës daton në vitin 2009. Qeveria e Kosovës, që nga ky vit e ka bërë praktikë tanimë që të t'i procedojë këto dokumente në çdo fillim të vitit krahas atyre si: Strategjia Legjislative, Planin e Veprimit për Partneritetin Privat etj. Gjithashtu, në kuadër të kësaj, Qeveria ka potencuar që për çdo 3 muaj të bëjë një vlerësim të asaj se sa është zbatuar në praktikë ky plan. Mirëpo, një vlerësim i tillë nuk është bërë as për Planin e Punës të 2009 dhe as në atë të 2010. Mbetet të shihet nëse për këtë vit do të ndodh e kundërta.

Qeveria miraton Raportin Vjetor Financiar për Vitin 2010

Raporti nuk është dërguar në Kuvendin e Kosovës deri më 6 prill 2011, apo gjashtë ditë më vonë se që parashihet me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike. Në 2010 u shpenzuan 93 milion euro më shumë se sa që ishin të hyrat.

Në mbledhjen e 7-të, të mbajtur më 30 Mars 2011, Qeveria e Kosovës me vendimin 07/7 miratoi Raportin Vjetor Financiar për Vitin 2010. Sipas nenit 46 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike, jo më vonë se me 31 Mars të çdo viti kalendarik, Ministri do t'i përgatisë dhe dorëzojë Qeverisë, për miratim dhe dorëzim në Kuvend, një raport përfundimtar përmbledhës të buxhetit për vitin e kaluar fiskal dhe dy vitet paraprake fiskale. Për të respektuar afatin ligjor, Qeveria miratoi Raportin Vjetor Financiar për 2010, edhe pse ai nuk ishte i gatshëm në kohën kur u miratua. Pasqyrat financiare për 2010 ende nuk janë audituar nga Zyra e Auditorit Gjeneral, ashtu siç parashihet me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike.

Raporti Vjetor Financiar 2010 është nënshkruar nga Ministri i Financave më 28 mars, është miratuar në Qeveri më 31 mars, kurse është protokolluar në Kuvend më 6 prill. Protokollimi në Kuvend është bërë 6 ditë pas afatit ligjor të paraparë me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike. Raporti është diskutuar në Komisionin Parlamentar për Buxhet dhe Financa më 4 maj 2011 dhe pritet të miratohet në seancën e ardhshme të Kuvendit me rekomandimet e komisionit.

Sipas Raportit Vjetor Financiar për 2010, të hyrat buxhetore kanë qenë 1 miliard e 194 milion euro, kurse është shpenzuar më shumë se sa kanë qenë të hyrat për 93 milion euro (1 miliard e 287 milion euro). Krahasuar me vitin 2009, të hyrat në

Buxhetin e Kosovës kanë qenë më të mëdha për 34 milion euro, kurse shpenzimet janë më të mëdha për 35 milion euro.

Ashtu si edhe në vitet e kaluara, të hyrat më të mëdha buxhetore erdhën nga doganat (699.3 milion euro), pas doganave radhitet Administrata Tatimore e Kosovës (194.2 milion euro), të hyrat vetanake 100.4 milion euro (52 milion komunat dhe 48.4 njësitë qendrore), grantet dhe ndihmat (45.3 milion) dhe të hyrat tjera (130.6 milion euro).

Pjesa më e madhe e mjeteve buxhetore u investuan në projekte kapitale (459.2 milion), pas saj vijnë shpenzimet për rroga (316.2 milion euro), subvencionet dhe transferet (253.4 milion euro), mallëra dhe shërbime (167.1 milion euro), etj.

Nëse krahasojmë Raportin Vjetor Financiar për Vitin 2010 me Projektligjin për Buxhetin e vitit 2011, shohim se qeveria parasheh që të hyrat totale në vitin 2011 të jenë 1.264 milion euro, apo 70 milion më shumë se të hyrat e realizuara në vitin 2010, ndërkaq shpenzimet e parashikuara për vitin 2011 pritet të jenë 1.434 milion euro, apo 147 milion më shumë se ato të vitit 2010. 140 milion euro nga këto shpenzime shtesë do të jenë rezultat i vendimit të Qeverisë për rritje pagash (vendimi 01/151 dhe vendimi 02/151 i 6 janarit 2011).

Qeveria e Kosovës duhet të miratojë edhe Raportin për Shpenzimet Buxhetore për tre mujorin e parë të 2011, ashtu siç parashihet me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike.

Ndryshohet përbërja e Komisionit për privatizimin e Distribucionit dhe Furnizimit

Katër nga pesë anëtarët e komisionit janë emra të rinj

Në mbledhjen e 4-të të Qeverisë, të mbajtur më 11 mars 2011, me vendimin 02/4 u miratuan emrat e rinj që e përbëjnë Komisionin për privatizimin e Distribucionit dhe Furnizimit të KEK-ut. Në përbërjen e re bëjnë pjesë:

- Besim Beqaj, Ministër i Zhvillimit Ekonomik, kryesues;
- Mimoza Kusari Lila, Ministre e Tregtisë dhe Industrisë;
- Bedri Hamza, Ministër i Financave;
- Nenad Rashiq, Ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale, dhe;
- Dardan Gashi, Ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Në mbledhjen e 39-të, të mbajtur më 8 tetor 2008, Qeveria e kaluar kishte marrë vendim që të privatizojë njësinë e Distribucionit dhe Furnizimit të KEK-ut sh.a. Krahas kësaj, si hap i parë në vazhden e udhëheqjes së këtij procesi, Qeveria në atë mbledhje mori vendim që të themelojë një komision qeveritar për privatizimin e Njesisë së Distribucionit dhe Furnizimit të KEK-ut sh.a.

Komisioni i deritanishëm kishte në përbërje këta anëtarë:

- Ahmet Shala, Ministër i Ekonomisë dhe Financave, kryesues;
- Lutfi Zharku, Ministër i Tregtisë dhe Industrisë;
- Justina Pula, Ministre e Energjisë dhe Minierave;
- Nenad Rashiq, Ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe;
- Mahir Jaghillar, Ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Pra, katër nga pesë anëtarët e komisionit janë emra të rinj, kurse arsyeja e këtij ndryshimi vjen si pasojë e ndryshimit të ministrave nga mandati i kaluar. Procesi i privatizimit të Njesisë së Distribucionit dhe Furnizimit të KEK-ut pritet të përmbyllet brenda këtij viti dhe është njëra ndër kushtet që Qeveria e Kosovës ka marrë përsipër ta plotësojë në kuadër të marrëveshjes "Stand by" me FMN-në të nënshkruar në korrik 2010.

Miratohet Rregullorja për Departamentet për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave në kuadër të Ministrive

Ky departament themelohet në kuadër të çdo Ministrie dhe vepron nën mbikëqyrjen e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë përkatëse.

Qeveria në mbledhjen e saj të dytë, me vendimin 02/02, miratoi Rregulloren për Departamentet për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave në kuadër të Ministrive. Qëllimi i kësaj rregulloreje është që të përcaktojë funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë si dhe statusin e Departamenteve për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave në Kuadër të Ministrive.

Sipas nenit 3 dhe 4 të kësaj rregulloreje funksionet dhe përgjithësitë e këtij departamenti janë të shumta si: koordinimi i procesit për integrim evropian; koordinimi i procesit për planifikim strategjik dhe zhvillim politik dhe koordinimi i asistencës së jashtme. Njëkohësisht ky departament ndihmon dhe këshillon në përcaktimin dhe vendosjen e prioritetëve duke marrë parasysh obligimet që dalin nga procesi i integritit evropian; koordinon punën në zhvillimin e dokumenteve kryesore strategjike; siguron pajtueshmërinë e politikave, planeve dhe strategjive me standardet e BE-së, etj. Në kuadër të Departamentit ekzistojnë dy divizione: Divizioni i Integritit Evropian dhe i Koordinimit të Politikave, përderisa departamenti udhëhiqet nga Drejtori i Departamentit, i cili bashkëpunon ngushtë me Zyrën e Kryeministrit, Ministrinë e Integritit Evropian dhe me Ministrinë e Financave.

Qeveria miratoi Planin e Veprimit për 10 prioritetet kyçe të Qeverisë së Kosovës në fushën e integritit evropian

Kjo është hera e parë që Qeveria e Kosovës kufizohet në prioritetet kyçe. Planet e Veprimit për Partneritet Evropian (PVPE) të cilat janë miratuar për qdo vit nga Qeveria, përmbanin deri në 1600 aktivitete që duhej përmbushur dhe të cilat nuk mund të plotësoheshin as në masën 20%.

Në mbledhjen e tretë të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria me vendimin 03/03 miratoi Planin e Veprimit për 10 prioritetet kyçe të Qeverisë së Kosovës. Duke u bazuar në rekomandimet e strategjisë së zgjerimit dhe raportit të progresit të Komisionit Evropian dhe duke pasur parasysh prioritetet kryesore të Qeverisë dhe Planin e punës, Ministria e Integritit Evropian ka koordinuar planin e veprimeve konkrete duke i adresuar prioritetet kryesore të Qeverisë në fushën e integritit Evropian. Prioritetet kyçe të Ministrisë së Integritit Evropian për vitin 2011 janë:

1. Forcimi i Reformës së Administratës Publike (Prioritet Strategjik i Qeverise për vitin 2011);
2. Forcimi i luftës kundër korrupsionit (Prioritet Strategjik i Qeverise për vitin 2011);
3. Lufta kundër krimit të organizuar dhe shpëlarjes së parave (Prioritet Strategjik i Qeverise për vitin 2011);
4. Menaxhimi efikas dhe efektiv i parasë publike – avancimi i sistemit të prokurimit publik, fuqizimi i mekanizmave për mbledhjen e të hyrave buxhetore, shpenzimi efektiv i buxhetit (Prioritet Strategjik i Qeverise për vitin 2011);
5. Forcimi i reformës së gjyqësorit (Prioritet Strategjik i Qeverise për vitin 2011);
6. Implementimi i Strategjisë për Liberalizimin e Vizave (Prioritet politik i Qeverisë);
7. Negocimi i marrëveshjes tregtare me BE-në dhe zhvillimi i legjislacionit dhe politikave të tregut të brendshëm dhe konkurrencës në harmoni me acquis (Prioritet politik i Qeverisë dhe prioritet Strategjik për vitin 2011);
8. Mirëmbajtja e marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe pjesëmarrja konstruktive në takimet rajonale (Prioritet Strategjik i Qeverise për vitin 2011);
9. Infrastruktura – energjia, transporti dhe bujqësia (Prioritet Strategjik i Qeverise për vitin 2011);
10. Shëndetësia dhe mjedisi (Prioritet Strategjik i Qeverise për vitin 2011);

Ndryshe nga vitet e kaluara Ministria për Integrim Evropian në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse ka paraparë dhe siguruar koston buxhetore të çdo veprimi.



PTK ndan edhe 40 milionë euro për buxhetin

Në mbledhjen e 3-të të Qeverisë së Kosovës, të mbajtur më 9 mars 2011, u morr vendim që të ndahen edhe 40 milionë euro dividendë nga PTK-ja.

Në vazhden e përpjekjeve të Qeverisë për të mbuluar shpenzimet e mëdha buxhetore që pësuan si rezultat i vendimit të kësaj të fundit për t'i rritur pagat e shërbyesve civilë dhe kategorive tjera, në konsultim me Bordin e Drejtorëve të PTK-së është rënë dakord që duke mos evituar problemet që do të mund të hasen në zbatimin e biznes-planit të PTK-së, Qeveria si aksionar në bazë të Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike, t'i kërkojë PTK-së që të deklarojë dividendën prej 40 milionë eurove. Kjo është hera e tretë që kjo ndërmarrje deklaroi dividendë.

Të kujtojmë që Qeveria Thaçi 1, më herët kishte marrë dy vendime të së njëjtës natyrë, përkatësisht

më 14 korrik 2009 ku ishte marr vendimi për deklarimin e dividendës në shumën prej 200 milionë euro si dhe 13 maj të vitit pauses edhe të 80 milionë euro të tjera. Duke mbledhur të gjitha shumat e dividendave të deklaruara nga ana e PTK-së deri më tani, përfshirë këtu edhe vendimin e fundit, gjithsej 320 milionë euro janë derdhur në buxhetin e Kosovës.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, Qeveria e Republikës së Kosovës u bë ushtrues i ligjshëm i të drejtave të aksionarit në Ndërmarrjen Publike "PTK" sh.a. dhe që atëherë gëzon të drejtën që të kërkojë nga kjo ndërmarrje deklarimin dhe pagesën e dividendës për aksionarin.



Ndryshohet përbërja e Komisionit qeveritar për privatizimin e PTK-së

Katër nga 5 anëtarët e Komisionit Ndërmintor për privatizimin e PTK-së do të jenë emra të ri. Edhe me këtë vendim Qeveria ka konfirmuar se planifikon të privatizoj 75% të aksioneve të PTK.

Në mars të vitit 2008 (Vendimi nr.07/02), në kuadër të procesit të privatizimit të PTK-së, Qeveria e asaj kohe kishte marr vendim që të themeloj Komisionin Ndërmintor për privatizimin e kësaj ndërmarrjeje. Komisioni përbëhej nga:

- Ahmet Shala, Ministër i Ekonomisë dhe Financave, kryesues;
- Lutfi Zharku, Ministër i Tregtisë dhe Industrisë;
- Fatmir Limaj, Ministër i Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit;
- Nenad Rashiq, Ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale;
- Sadri Ferati, Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal.

Pas zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare, konfiguracioni i partive politike të përfaqësuar në parlament dhe kabinet qeveritar ndryshoi, ku LDK, ministra të së cilës ishin të përfaqësuar në këtë komision, tani në mandatin e dytë të qeverisë Thaçi nuk bëjnë pjesë dhe kështu, duhej që ky komision të ndryshojë edhe përbërjen. Poashtu, në mandatin e dytë të Qeverisë Thaçi, është vendosur që të ndryshohet edhe emërtimi i ministrive.

Si rrjedhojë, Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e saj të 2-të, të mbajtur më 2 mars 2011, morri vendim që të ndryshojë përbërjen e këtij komision ndërmintor duke emëruar ministra të tjerë në vend të atyre që nuk bëjnë pjesë në mandatin e tanishëm. Komisioni i ri ndërmintor për privatizimin e PTK-së do të ketë tani këtë përbërje:

- Besim Beqaj, Ministër i Zhvillimit Ekonomik, kryesues;
- Mimoza Kusari, Ministre e Tregtisë dhe Industrisë;
- Fehmi Mujota, Ministër i Infrastrukturës;
- Nenad Rashiq, Ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale;
- Bedri Hamza, Ministër i Financave.

Strategjia për Privatizimin e PTK kishte shërbyer si shkas për prishjen përfundimtare të koalicionit PDK-LDK e cila rezultoi në zgjedhje të parakohshme. Kjo Strategji është shqyrtuar dy herë në Kuvend gjatë 2010. Për shkak problemeve që e kanë përcjell miratimin e saj, Gjykata Kushtetuese është duke bërë një vlerësim rreth asaj se a ka qenë proceduralisht në rregull miratimi i kësaj Strategjie në Kuvendin e Kosovës.

MPJ pritet të ketë një agjendë lobuese për shtimin e njohjeve si dhe Strategjinë për Politikë të Jashtme 2011-2015

MPJ do t'i koordinojë aktivitetet me ministrinë e linjës, shoqërinë civile dhe të gjithë akterët e tjerë me ndikim që të kontribuojnë në hartimin e këtyre dokumenteve dhe pastaj zbatimin e tyre.

Kërkesa e grupeve të ndryshme të interesit, e posaçërisht të sektorit të shoqërisë civile më në fund po has në mirëkuptim nga ana e institucioneve qeveritare. Në këtë rrafsh, për shkak të ritmit tepër të ultë të procesit të njohjeve ndërkombëtare për Kosovën, shoqëria civile dhe akterët e tjerë kanë kërkuar disa herë që institucionet përgjegjëse, në këtë rast Qeveria e Kosovës të hartojë një strategji për shtimin e njohjeve, kërkesë e cila për arsye të ndryshme nuk ishte marrë parasysh nga kjo e fundit deri me datën 2 mars 2011 kur u vendos të iniciohet hartimi i agjendës lobuese për shtimin e njohjeve të Republikës së Kosovës nga vendet që ende nuk e kanë ndërmarrë një veprim të tillë. Me këtë vendim,

rolin për të hartuar këtë agjendë do ta ketë MPJ e cila në koordinim me ministrinë e linjës, shoqërinë civile dhe të gjithë akterët e tjerë me ndikim do të kontribuojnë në hartimin e kësaj agjende dhe pastaj zbatimin e saj.

Gjithashtu, Qeveria e Kosovës, në po të njëjtën mbledhje, morri parasysh propozimin e dytë të MPJ-së për iniciimin e hartimit të Strategjisë për Politikë të Jashtme të Republikës së Kosovës për periudhën 2011-2015. Kosova, në rrafshin e politikës së jashtme është ende në fazat e hershme të konsolidimit të politikës së saj jashtme dhe hartimi i një dokumenti të tillë do t'i shërbejë shumë mbrojtjes së interesave të shtetit në rrafshin politik dhe ekonomik kundrejt rrjedhave gjeostrategjike globale.

Miratohet Raporti i Vlerësimit të Përshtatshmërisë së Sistemit të Financimit për Komuna në vitin 2010

Në vitin 2010, komunat kanë gjeneruar rreth 52.1 milion euro, një rritje kjo prej rreth 7.2% krahasuar me vitin 2009.

Rregullimi i drejtë i financimit të komunave përmes granteve nuk mund të jetë proces i përfunduar, para përmbylljes së regjistrimit të popullsisë.

Në mbledhjen e 7-të, të mbajtur më 30 Mars 2011, Qeveria e Kosovës ka miratuar Raportin e Vlerësimit të Përshtatshmërisë së Financimit për Komuna në vitin 2010. Qëllimi i këtij raporti është të vlerësoj sistemin e financimit të komunave përmes granteve të përgjithshme apo atyre specifike, siç janë granti për Arsim dhe ai për Shëndetësi. Gjithashtu në këtë raport jepen edhe rekomandime se si duhet vazhduar në të ardhmen.

Sipas këtij raporti, granti i përgjithshëm me sistem të mbyllur përbën 10% të të hyrave të projektuara të buxhetit qendror. Ky grant më parë alokohej për kokë banori, ndërsa tani janë shtuar edhe disa parametra të tjerë alokues që kryesisht reflektojnë diversitetin etnik dhe territorial të komunave. Implementimi i këtyre parimeve të reja ka rezultuar në rritje të shumës totale në grantin e përgjithshëm në vitin 2010, ku si shtesë është futur rritja nominale e popullsisë.

Granti specifik i arsimit parauniversitar për komuna është rritur për 10%, megjithatë vazhdimisht janë vërejtur dobësi në anën e MASHT-it në zbatimin e besueshëm të financimit përmes këtij granti, parregullsi këto që kanë ardhur kryesisht si rezultat i mungesës së statistikave objektive, të sakta dhe të besueshme të arsimit. Ndërkaq granti specifik për shëndetësi, që do të duhej të konsideronte faktorë si mosha, struktura gjinore e popullsisë, numri mesatar i vizitave të regjistruara dhe kostoja mesatare e shërbimeve në çdo komunë, është përqendruar vetëm në alokimin për kokë banori, për shkak të mungesës së statistikave demografike.

Të hyrat vetanake të komunave janë gjeneruar përmes mbledhjes së taksave komunale, tarifave për leje ndërtimi, ngarkesave mbi një shkallë të gjerë të aktiviteteve dhe dokumenteve civile dhe përmes pronave të patundshme komunale. Në vitin 2010, komunat kanë gjeneruar rreth 52.1 milion euro, një rritje kjo prej rreth 7.2% krahasuar me vitin 2009. Të hyrat më të larta janë realizuar përmes tatimit në pronë, 13.4 milion euro, dhe taksave për ndërtim 12.1 milion euro.

Parregullsitë e vërejtura në financimin e komunave janë konsideruar të rezultojnë nga mungesa e sistemeve cilësore informative për menagjimin e të dhënave të nevojshme.

Themelohet Njësia për Bashkëpunim Ndërkombëtar për zbatim të ligjit

Kjo njësi, si qëllim të saj primar do të ketë koordinimin e aktiviteteve në mes të agjencive për zbatim të ligjit në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit.

Në kuadër të përpjekjeve për të zgjeruar bashkëpunimin me vendet e tjera të rajonit dhe më gjerë, është kruciale që të ketë bashkëpunim dhe koordinim sa më të frytshëm në funksion të zbatimit të ligjit në mes të vendeve të ndryshme e në veçanti atyre të rajonit të Ballkanit ku shtetet po hasin në vështirësi të mëdha sa i përket sundimit të ligjit. Krimi i organizuar dhe korrupsioni vazhdojnë të jenë një ndër brengat më të mëdha të këtyre vendeve duke përfshirë këtu edhe Kosovën dhe si pasojë, për luftimin e këtyre dukurive, domosdo duhet të koordinohen veprimet e agjencive për zbatim të ligjit të të gjitha vendeve në mënyrë që suksesi në këtë drejtim të jetë më i madh.

Si rrjedhojë e këtij procesi, me propozim të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e dytë të saj, të mbajtur më 2 mars 2011, miratoi vendimin për themelimin e Njesisë për Bashkëpunim Ndërkombëtar për zbatimin e ligjit (ILECU – International Law Enforcement Coordination Unit) që do të jetë funksionale në kuadër të Policisë së Kosovës. Në kuadër të kësaj njësie do të inkorporohen: zyra e INTERPOL-it, EUROPOL-it, EUROJUST-it dhe FRONTEX-it.

Kjo njësi, si qëllim të saj primar do të ketë koordinimin e aktiviteteve në mes të agjencive për zbatim të ligjit në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit. Po ashtu, me qëllim të koordinimit të bashkëpunimit ndërkombëtar brenda kësaj njësie parashihet të nënshkruhet një marrëveshje e bashkëpunimit në mes të MPB, MD, MF dhe Prokurorisë së Shtetit.



Kosova me 14 pika të rregullta kufitare

U hap pika kufitare në fshatin Stançiq – Bellanovc në kufirin me Maqedoninë

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e dytë të përbërjes së re qeveritare, me vendimin 09/02 rikategorizoi pikën kufitare lokale “Stançiq” në kufi me Maqedoninë në pikë kufitare rajonale apo pikë kufitare e kategorisë A. Iniciativë për këtë rikategorizim erdhi nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Kosova deri më tani ka pasur vetëm dy pika të kalimit kufitar të trafikut rrugor me Maqedoninë, atë të Hanit të Elezit dhe të Gllloboqicës, ndërsa si pikë kalimin kufitar të trafikut hekurudhor në mes të Republikës së Kosovës me Republikën e Maqedonisë është vetëm ajo e Hanit të Elezit.

Për momentin pika e vendkalimit kufitar në fshatin Stançiq – Bellanovc nga ana e Maqedonisë është

e karakterit lokal, ndërkombëtarizimi i kësaj pike kufitare do të krijojë lehtësira të shumta në drejtim të qarkullimit të qytetarëve dhe mallrave të rajonit që përfshijnë kjo pikë e kalimit kufitar.

Sipas Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Kufirit, e miratuar në prill të 2008, Republika e Kosovës ka 13 pika të rregullta kufitare dhe dy të përkohshme - në Krushqevë dhe Orqushë. Gjithashtu në Maj të vitit 2009, Qeveria pati hapur përkohësisht edhe dy pika të përkohshme kufitare me Shqipërinë, Gllloboqicë – Borje dhe në Gorozhub – Pogaj. Me shtimin e kësaj pike kufitare Kosova tani do t'i ketë 14 pika të rregullta kufitare.

Ky projekt do të financohet nga programi IPA instrument financiar i Komisionit Evropian.



Organizohet Epopeja e UÇK

Edhe pse një manifestim tani më i rregullt dhe i cili mbahet nën patronatin e Zyrës së Kryeministrit, mjetet për organizimin e Epopesë së UÇK nuk përfshihen në ndarjet e rregullta buxhetore por meren gjithnjë nga shpenzimet e paparashikuara

Qeveria e Republikës së Kosovës që nga paslufta ka ndarë mjete financiare për manifestimin tregues të Epopesë së UÇK-së me rastin e rënies heroike të komandantit legjendar të UÇK-së Adem Jashari dhe familjes së tij. Me vendimin 08/02, Qeveria ndau 40 mijë euro për organizimin e këtij manifestimi, që u mbajt më datat 5, 6 dhe 7 mars të këtij viti. Manifestimi qendror me moton "Nderojmë Historinë- Ndërtojmë të Ardhmen" u zhvillua në kazermën Adem Jashari në Prishtinë ndërsa me ndezjen e zjarreve në Prekaz u përmbyll ky manifestim tradicional i Epopesë së UÇK-së.

Ky është përvjetori i 13 i rënies së dëshmorit Adem Jashari dhe familjes së tij.

Të rikujtojmë se që nga viti 2008 deri më tani Qeveria ka ndarë gjithsej 110.000 mijë Euro për organizimin e aktiviteteve, me rastin e shënimit të manifestimit gjithë popullor "Epopeja e UÇK-ës. Edhe pse një manifestim tani më i rregullt dhe i cili mbahet nën patronatin e Zyrës së Kryeministrit, mjetet për organizimin e Epopesë së UÇK nuk përfshihen në ndarjet e rregullta buxhetore por merren gjithnjë nga shpenzimet e paparashikuara.



Ministri i Financave autorizohet që të bëjë transfere deri në 20 mijë euro

Në po të njëjtën mbledhje, me vendimin 05/03, Qeveria ndau mjete financiare në vlerë prej 5.000 euro për familjen e fëmijës së vrarë, Leutrim Musliu nga fshati Uglar, Komuna e Gjilanit.

Duke u bazuar në Nenin 29.3 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike, Qeveria mund të autorizojë Ministrin e Financave që të aprovojë transfere nga programi i shpenzimeve të paparashikuara në programin tjetër në tabelat 3.1 dhe 4.1 të buxhetit, për shumat individuale të kërkuara deri në vlerë prej 20 mijë euro.

Andaj me vendimin 04/03, Qeveria autorizon Ministrin e Financave që të aprovojë transfere nga programi për shpenzime të paparashikuara për shumat individuale të kërkuara deri në vlerë prej

20.000 euro. Shuma e totalit të këtij autorizimi të dhënë për Ministrin nuk mund të kalojë 20% të shumës së ndarë vjetore të programit shpenzimet të paparashikuara.

Në bazë të Nenit 29 të Ligjit të menaxhimit të financave publike dhe përgjithësive, organizatat buxhetore mund të aplikojnë në Ministrinë e Financave për fonde shtesë nëse ndodh një rast në të cilin nevojiten shpenzime urgjente ose të paparashikuara duke shpjeguar rrethanat të cilat kanë shkaktuar nevojën për fonde shtesë.



Miratohet Udhëzimi Administrativ për Përcaktimin e Procedurave pas Bartjes së Përgjegjësisë së Shërbimeve Sociale dhe Familjare në nivel komunal

Në po të njëjtën mbledhje, me vendimin 05/03, Qeveria ndau mjete financiare në vlerë prej 5.000 euro për familjen e fëmijës së vrarë, Leutrim Musliu nga fshati Uglar, Komuna e Gjilanit.

Në mbledhjen e tretë të Qeverisë, me vendimin 02/03, u miratua Udhëzimi Administrativ për Përcaktimin e Procedurave pas Bartjes së Përgjegjësisë të Shërbimeve Sociale dhe Familjare në nivel komunal. Qëllimi kryesor i këtij Udhëzimi Administrativ është që të definohen dhe përcaktohen procedurat e zbatimit të legjislacionit të shërbimeve sociale dhe familjare në nivelin lokal, nëpër të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, pas bartjes së përgjegjësisë nga niveli qendror në nivelin lokal, sipas Marrëveshjes së Mirëkuptimit të nënshkruar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Ministria e Administratës së

Pushtetit Lokal (MAPL), Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave (MEF) dhe komunave të Kosovës.

Sipas Nenit 2 të këtij UA, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) është organ përgjegjës shtetëror i caktuar për organizimin e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare së bashku me njësitë e qeverive lokale si dhe për mbikëqyrjen e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Ndërsa, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave janë përgjegjëse për bashkërendimin e procesit të përgjithshëm të bartjes

së kompetencave nga lëmi i shërbimeve sociale dhe familjare nëpër komuna dhe do të kujdesen që ky proces të jetë në përputhshmëri të plotë me legjislacionin në Kosovë.

Ndërsa, të gjitha komunat në territorin e Republikës së Kosovës sipas kompetencave vetanake janë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare, përmes Qendrave të tyre për Punë Sociale, dhe institucioneve tjera qeveritare dhe joqeveritare, nën mbikëqyrjen e MPMS-së. Me bartjen e përgjegjësisë nga MPMS-ja tek komunat, komuna është institucion publik profesional i nivelit komunal, kompetente për mbrojtjen e qytetarëve në nevojë sociale, si dhe përgjegjëse për themelimin e së paku një Qendre për Punë Sociale që do

të ofrojë shërbime sociale dhe familjare, sipas nenit 7 pika 7.1 të Ligjit mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare nr. 02/L-17. Për ofrimin e këtyre Shërbimeve Sociale dhe Familjare, komuna duhet të caktojë personel të përbërë nga profesionistët me kualifikime dhe trajnime përkatëse dhe numër të duhur të personelit, konform standardeve minimale që përcakton MPMS-ja.

MEF-i është i obliguar që t'u alokojë komunave mjete buxhetore sipas grantit specifik për shërbime sociale, grante të cilat nuk mund të përdoren për qëllime të tjera, përveç për financimin e shërbimeve sociale dhe familjare, ndërsa MPMS-ja do të përcaktojë kriteret e shpërndarjes sipas formulës së dizajnuar, dhe është përgjegjëse për interpretimin e këtij udhëzimi administrativ.

Qeveria miraton Rregullore, në mungesë të Ligjit për Qeverinë

*Miratohet Rregullorja për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe të ministrive
Kjo rregullore përcakton fushat e përgjegjësisë dhe numrin e autoriteteve të larta të administratës
shtetërore, si dhe fushat e përgjegjësisë dhe numrin e organeve të larta të administratës shtetërore*

Me vendimin 04/05, Qeveria e Kosovës miratoi Rregulloren për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe të ministrive. Me anë të kësaj rregulloreje përcaktohen fushat e përgjegjësisë dhe numri i autoriteteve të larta të administratës shtetërore, si dhe fushat e përgjegjësisë dhe numri i organeve të larta të administratës shtetërore. Sipas Nenit 3 të rregullores, autoritetet e larta të administratës qendrore janë Qeveria në tërësi, Kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat, të cilët udhëheqin dhe mbikëqyrin administratën shtetërore në fushat e tyre përkatëse. Në Nenet 4, 5, 6, 7, 8 janë përshkruar kompetencat e Qeverisë dhe të anëtarëve të Qeverisë, Kryeministrit, zëvendëskryeministrave dhe ministrave.

Sipas Nenit 4, Qeveria ushtron pushtetin e vet ekzekutiv në përputhje me Kushtetutën dhe

legjislacionin në fuqi që ka të bëjë me Qeverinë, duke marrë vendime me propozimin e autoriteteve të larta të administratës shtetërore, si dhe duke nxjerrë akte juridike ose rregullore të nevojshme për zbatimin e ligjeve. Ndërsa, Anëtarët e Qeverisë e mbështesin punën e Qeverisë, ku e kanë të drejtën të ngrenë iniciativë për përgatitjen e projektligjeve si dhe të propozojnë politika që kanë të bëjnë me ministrinë përkatëse, etj.

Ndërkaq, në Nenin 6 janë përshkruar kompetencat e Kryeministrit, i cili përveç që ushtron pushtetin e vet ekzekutiv në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, ai gjithashtu përfaqëson dhe udhëheq Qeverinë, duke konceptuar, propozuar dhe zbatuar drejtimet kryesore të politikës shtetërore dhe duke u përgjigjur për to. Ai po ashtu ka përgjegjësi të kontrollojë edhe punën e anëtarëve të Qeverisë. Në

neni 16 të po kësaj rregulloreje, janë të përshkruara edhe funksionet e Zyrës së Kryeministrit, e cila mbështet veprimtarinë e Kryeministrit, të Qeverisë, të zëvendëskryeministrave/eve dhe ministrave/eve dhe përgjegjësi të tjera.

Neni 7, flet për funksionet e Zëvendëskryeministrave, të cilët përveç që e ndihmojnë kryeministrin në caktimin e prioritetëve, në zhvillimin dhe zbatimin e politikave të Qeverisë, ata me autorizimin e Kryeministrit marrin pjesë edhe në hartimin e vendimeve dhe akteve të tjera si dhe mbikqyrin aktivitetet e organeve operative të Qeverisë. Ndërsa, Neni 8 përshkruan funksionin e ministrave të cilët udhëheqin dhe përfaqësojnë ministrinë duke

iu përgjigjur Kryeministrit dhe Kuvendit për çështjet që kanë të bëjnë me ministrinë e tij/saj. Po ashtu propozojnë projektligje si dhe nxjerrin vendime dhe akte nënligjore. Në këtë rregullore si aneks shtesë janë të përshkruara edhe fushat dhe përgjegjësisë e gjithsej 18 ministrive që ka Qeveria e Republikës së Kosovës.

Së fundi, zbatimi i kësaj rregulloreje sigurohet nga Kryeministri, mbështetjen e Zëvendëskryeministrit të parë dhe Zëvendëskryeministrave.

Kosova ende nuk ka ligj për Qeverinë. Në vend të kësaj rregulloreje, qeveria do të duhej të procedonte në Kuvend Projektligjin për Qeverinë. Ky Projektligj është paraparë me Strategjinë Legjislative 2011 dhe pritet të miratohet në fillim të qershorit 2011.

Ndryshohet dhe Plotësohet Ligji për Akreditim

Ky Projektligj hap rrugë për implementimin e direktivave evropiane të akreditimit të cilat do të mundësojnë qasje më të lehtë në fushat e akreditimit

Në mbledhjen e shtatë të Qeverisë, me vendimin 02/07, Qeveria miratoi Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Akreditim. Ligji për Akreditim u miratua në nëntor të vitit 2008. Me anë të këtij Ligji u mundësua rregullimi, themelimi dhe funksionimi i organit që kryen punët e shërbimit të akreditimit në Kosovë, si dhe përcaktohen fushat dhe roli i akreditimit në procedurat e vlerësimit të konformitetit, në pajtim me standardet e rregullta ndërkombëtare. Akreditimi është vullnetar dhe bazohet në këto parime: paanshmëria, transparencia, kompetenca profesionale, ruajtja e konfidencialitetit si dhe përputhshmëria me rregullat dhe me procedurat e akreditimit në Evropë dhe në nivel ndërkombëtar. Ndërsa sipas nenit 6 të Ligjit për Akreditim, fushë - veprimtaritë e akreditimit janë:

1. akreditimi i laboratorëve testues dhe kalibruës;
2. akreditimi i organit certifikues të sistemeve të menaxhimit;
3. akreditimi i organit certifikues të personelit;
4. akreditimi i organit certifikues të produkteve;
5. akreditimi i organit certifikues të mbrojtjes së ambientit;
6. akreditimi i organit inspektues.

Në kuadër të këtij Ligji është formuar edhe Drejtoria e Akreditimit të Kosovës që vepron në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Kjo drejtori është anëtare në Korporatën Evropiane të Akreditimit si dhe anëtare me të drejta të plota në Forumin Ndërkombëtar të Akreditimit si dhe Organizatën Ndërkombëtare të Akreditimit të Laboratorëve. Gjatë raportimit të Drejtorisë së Akreditimit para

Komisionit Evropian, është sugjeruar që Ligji për Akreditim të harmonizohet me rregulloren 765/2008 e cila ka hyrë në fuqi me 1 janar të vitit 2010.

Ndryshimet dhe plotësimet në këtë ligj më së shumti i kanë pësuar Neni 7, Neni 9 dhe Neni 14. Pas paragrafit 1 të Nenit 7, i cili shpjegon detyrat e Drejtorisë së Akreditimit të Kosovës (DAK), janë shtuar edhe disa paragrafë të tjerë duke i shtuar përgjegjësit e këtij departamenti ku përpos ofrimit të ekspertizës për çështjet që lidhen me akreditimin dhe vlerësime të tjera të kompetencës teknike, etj, detyra të reja tani e tutje do të jene edhe ngritja e sistemi të menaxhimit të cilësisë, përgatitja e procedurave për një menaxhim më efikas, verifikimi i vlerësimeve dhe përgatitja e raporteve vjetore, publikimi i shpenzimeve vjetore të buxhetit, dhe akreditimi. Detyrë tjetër e DAK-së është edhe nënshtrimi i vlerësimit të

simotrave (peer evaluation) të cilat përcaktohen nga Kooperimi Evropian për Akreditim etj.

Edhe Neni 9, ku shpjegohen procedurat e Akreditimit, pas paragrafit 8 i janë shtuar edhe tre paragrafë të rinj ku thuhet se DAK-ja nuk do të ofrojë shërbime të cilat ofrohen nga Organizimi për Vlerësim të Konformitetit, njëkohësisht DAK-së i lejohet që të operojë edhe në territorin e një shteti tjetër, etj.

Ndërsa Neni 14, sa i përket Dispozitave kalimtare, pas paragrafit 1 shtohen paragrafët e rinj ku DAK si anëtare në Kooperimin Evropian për Akreditim, do të nënshkruajë marrëveshje multilaterale me Kooperimin Evropian për Akreditim për pranimin e certifikatave të Akreditimit në mes shteteve anëtare të Kooperimit Evropian për Akreditim.

Ky Projektligj hap rrugë për implementimin e direktivave evropiane të akreditimit të cilat do të mundësojnë qasje më të lehtë në fushat e akreditimit.

Ri-miratohet Projektligji për Gjendjen Civile dhe Projektligji për Shërbimet e Sigurisë Private

Ky Projektligj hap rrugë për implementimin e direktivave evropiane të akreditimit të cilat do të mundësojnë qasje më të lehtë në fushat e akreditimit

Pas shpërbërjes së Kuvendit, projektligjet është dashur të miratohen përsëri në ekzekutiv dhe më pas të procedohen edhe një herë Kuvend.

Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e saj të 6-të, të mbajtur 23 mars 2011 miratoi përsëri Projektligjin për Gjendjen Civile, i cili ishte miratuar në shtator të vitit të kaluar, gjegjësisht në mbledhjen e saj të 145-të. Mirëpo, me shpërbërjen e Kuvendit të Kosovës në dhjetor të 2010-ës, i është kthyer edhe njëherë Qeverisë për ri-miratim.

Në bazë të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit, që flet për punët e pambaruara, thuhet që “në fund të mandatit të këtij institucioni legjislativ, të gjitha punët që i janë besuar atij (Kuvendit) konsiderohen të përfunduara. Kjo nuk gjen zbatim në rastin e ligjeve të miratuara nga Kuvendi e të proceduara për shpallje, si dhe të peticioneve dhe të atyre punëve, që nuk kërkojnë të merret një vendim nga Kuvendi.” Pra, kërkohet që kryesisht së re të Kuvendit t’i riprocedohen nga Qeveria projektligjet që kanë mbetur në procedurë përgjatë mandatit paraprak.

Në bazë të Strategjisë Legjislative 2011, Projektligji për Gjendjen Civile është paraparë të miratohet më 31 mars 2011.

Në po të njëjtën mbledhje, me vendimin 05/07, Qeveria e Republikës së Kosovës miratoi Projektligjin për Shërbimet e Sigurisë Private. Ky Projektligj u pat miratuar nga Qeveria, me 12 gusht të vitit të kaluar, i cili më vonë u procedua në Kuvend, ku edhe i është bërë leximi i parë. Mirëpo me shpërbërjen e Kuvendit, në dhjetor të 2010-ës, i është kthyer Qeverisë për procedim duke u bazuar në Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës, respektivisht Neni 86—të ku thuhet se “në fund të mandatit të Kuvendit, të gjitha punët që i janë besuar atij konsiderohen të përfunduara. Kjo nuk gjen zbatim në rastin e ligjeve të miratuara nga Kuvendi e të proceduara për shpallje, si dhe të peticioneve dhe të atyre punëve, që nuk kërkojnë të merret një vendim nga Kuvendi”.

Ky Ligj gjithashtu është i paraparë edhe në Strategjinë Legjislative të viti 2011 për miratim me 31 mars të viti 2011. Institucioni përgjegjës për zbatimin dhe aplikimin e këtij projektligji është Ministria e Punëve të Brendshme të Kosovës.



Ndryshohet dhe plotësohet Ligji për Tregtinë e Brendshme

Me ndryshimet e bëra në projektligjin e ri pritët të ndiqen penalisht apo ndëshkohen shitësit ambulantë që ushtrojnë veprimtari tregtare e që në numër janë relativisht shumë anekënd Kosovës

Në mbledhjen e 7-të të Qeverisë së Kosovës, të mbajtur më 30 mars 2011, u miratua Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Tregtinë e Brendshme.

Ky projektligj ka pësuar ndryshime përgjithësisht në aspektin e shtimit të termeve të reja, riformulime të neneve, fshirje të shumë neneve të ligjit të vjetër, ripërcaktim të nivelit të gjobave në raste kur shkelen nene të veçanta të ligjit, etj.

Ndryshimet konsistojnë në fshirjen e neneve të ligjit në fuqi të cilat i përkasin të drejtave të konsumatorit të cilat nuk kanë ndonjë rëndësi të madhe apo nuk kanë kuptim, pastaj fshihet paragrafi 38.3 i nenit 28 i cili specifikon autorizimin e institucionit komunal për dhënien e lejes së punës, etj. Po ashtu, në nenin 61 të ligjit në fuqi ku janë të specifikuar nivelet e gjobave kundrejt personave juridikë dhe fizikë në raste kur shesin mallra në ambient të hapur, përkatësisht shtimin e neneve të reja ku dënohen

edhe personat fizikë krahas atyre juridikë të cilët e shkelin këtë nen. Pra, me gjobë në shumë prej 200 eurove deri në 600 euro ndëshkohet personi juridik si dhe me 500 euro deri në 1000 euro ndëshkohet personi fizik i cili shet mallra në ambient të hapur dhe nuk është i regjistruar.

Në përgjithësi, ndryshimet dhe plotësimet në Ligjin për Tregti të Brendshme janë më shumë të natyrës gjuhësore, por të domosdoshme për të bërë të mundur interpretimin dhe zbatimin e ligjit në mënyrë më efikase. Me këto ndryshime, pritët të ndiqen penalisht apo ndëshkohen shitësit ambulantë që ushtrojnë veprimtari tregtare e që në numër janë relativisht shumë anekënd Kosovës.

Sipas Strategjisë Legjislative 2010, projektligji në fjalë është paraparë të miratohet më 30 qershor 2011. Ligji për Tregtinë e Brendshme ishte miratuar në kohën e administrimit të UNMIK-ut, përkatësisht nga Kuvendi me 16 qershor dhe kishte hyrë në fuqi me shpalljen nga PSSP-ja me 20 tetor 2004.



Ndryshohet dhe Plotësohet Projektligji për Noterinë

Ky Projektligj i është kthyer Qeverisë për procedim duke u bazuar në Nenin 86-të të Rregullores e Kuvendit të Republikës së Kosovë.

Në mbledhjen e 6-të të Qeverisë së Kosovës, të mbajtur më 23 mars 2011, u miratua Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Noterinë. Projektligji në fjalë, ka pësuar ndryshime kryesisht në terminologji, fshirje të disa neneve të panevojshme si dhe ndryshime të tjera të vogla. Në aspektin e ndryshimeve në terminologji, është zëvendësuar emërimi "President i Gjykatës" në "Kryetar i Gjykatës", "President i Odës (së Avokatëve)" në "Kryetar i Odës (së Avokatëve)" etj. Gjithashtu, Ligji për Noterinë ka pësuar ndryshime kryesisht në renditjen e paragrafëve dhe nënparagrafëve, është fshirë nënparagrafi 1.4, i paragrafit 1 të nenit 30 që flet për themelimin e organeve të përbashkëta dhe kompanive të biznesit si dhe themelimin dhe ndryshimin e statuteve të organeve të kompanive të

tilla në kuadër të përpunimit të detyrueshëm noterial të dokumenteve. Po ashtu, termet që i përkasin ligjeve/rregulloreve që janë miratuar në kohën e UNMIK-ut janë zëvendësuar me ato të Republikës së Kosovës etj.

Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Noterinë, në bazë të Strategjisë Legjislative 2011, ishte paraparë të miratohej deri më 31 mars, gjë që është miratuar 8 ditë përpara këtij afati. Ligji mbi Noterinë kishte kaluar në Kuvend me 17 tetor 2008 dhe ishte shpallur nga Presidenti i Republikës me 6 nëntor të po të njëjtit vit.

Ky ligj konsiderohet nga shumë ekspertë të drejtësisë si një ndër ligjet më të rëndësishme që bën të mundur funksionimin efikas të sistemit të përgjithshëm të drejtësisë në vend.



Ndryshohet dhe plotësohet Ligji për Shoqëritë Tregtare

Projektligji i ndryshuar përmban në vete përgjithësisht zëvendësime terminologjike, ndryshim të afateve, shtim të kompetencave për Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve, etj.

Në mbledhjen e 7-të të Qeverisë së Kosovës, të mbajtur më 30 mars 2011, u miratua Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Shoqëritë Tregtare. Ndryshimet dhe plotësimet e bëra në këtë projektligj janë kryesisht të natyrës terminologjike dhe afatizuese si p.sh. termi “Ndërmarrje Individuale” zëvendësohet me “Biznes Individual”, pastaj “Shoqëri Kolektive” me “Ortakëri e Përgjithshme”, etj. Në aspektin e ndryshimeve në kuadër të afatizimeve që janë paraparë në ligjin e vjetër, ndryshimet janë si: afati në tërë tekstin e ligjit të vjetër prej 60 ditësh zëvendësohet me afatin prej 30 ditësh si dhe afati tjetër prej 10 ditësh kalendarike zëvendësohet me afatin prej 3 ditë pune, etj.

Gjithashtu, ndryshime dhe plotësime në ligjin e ri vërehen edhe në substancë si ndalimi i ushtrimit të veprimtarisë biznesore nga ndonjë shoqëri e cila nuk

është e regjistruar në bazë të rregullave apo ligjeve të vendit, ripërcaktimi i nivelit të gjobave në raste kur shkelen nenet përkatëse, shtimi i kompetencave të Agjencionit për Regjistrimin e Bizneseve i cili me ndryshimet e bëra ka kompetencë për t'i regjistruar edhe ato ndërmarrje publike të cilat kanë përfunduar procedurat e korporatizimit, procedurat e ankimeve nga ana e palëve të treta kundrejt këtij agjencioni, etj.

Sipas Strategjisë Legjislative 2011, të miratuar nga ana e Qeverisë më 16 mars (Vendimi 02/05), ky projektligj është paraparë të kalojë në Qeveri deri më 30 qershor. Gjithashtu, Ligji për Shoqëritë Tregtare deri më tani ka pësuar ndryshime dy herë (duke përfshirë edhe këtë të fundit): ndryshimi i parë ka kaluar në Qeveri më 16 prill 2010, pra afërsisht një vit nga miratimi i ndryshimeve të fundit.

Përmbledhje

Më poshtë janë të radhitura të gjitha vendimet e marra nga Qeveria gjatë muajit shkurt dhe mars 2011, ashtu siç janë marrë në formë kronologjike (mbledhjet 01 – 07):

1. Vendimet nga mbledhjes se parë te Qeverisë së Kosovës, mbajtur më 23 Shkurt 2011:
 - 1.1 Vendimi 01/01, Qeveria e Republikës së Kosovës i propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës zgjatjen e ndarjeve buxhetore për muajin mars të vitit 2011, të përcaktuara në Ligjin nr. 03/L-218, “Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-177 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010”.
2. Vendimet nga mbledhja e dytë e Qeverisë së Kosovës, mbajtur 2 Mars 2011:
 - 1.1 Vendimi 02/02, Miratohet Rregullorja për departamentet për integrim evropian dhe koordinim të politikave në kuadër të ministrive;
 - 1.2 Vendimi 03/02, Miratohet Udhëzimi Administrativ për përcaktimin e procedurave pas bartjes së përgjegjësi të shërbimeve sociale dhe familjare në nivelin komunal;
 - 1.3 Vendimi 04/02, Miratohet propozimi i Ministrisë të Punëve të Brendshme për themelimin e Njësisë për Bashkëpunim Ndërkombëtar në zbatim të Ligjit (ILECU);
 - 1.4 Vendimi 05/02, Miratohet kërkesa e Ministrisë së Punëve të Jashtme për hartimin e agjendës lobuese për shtimin e njohjeve të Republikës së Kosovës;
 - 1.5 Vendimi 06/02, Miratohet kërkesa e Ministrisë së Punëve të Jashtme për hartimin e strategjisë për politikë të jashtë të Republikës së Kosovës;
 - 1.6 Vendimi 07/02, Ndryshohet Vendimi 02/41 datë 23.10.2008 për themelimin e Komisionit Ndërmarrës që të analizojë opsionet për participimin e sektorit privat në PTK Sh.A duke përfshirë edhe privatizimin eventual të të gjitha apo disa njësive të biznesit të PTK Sh.A;
 - 1.7 Vendimi 08/02, Ndahen mjete financiare në shumën prej 40,000.00 euro për organizimin e aktiviteteve, me rastin e shënimit të manifestimit gjithë-popullor “ Epopeja e UÇK-së;
 - 1.8 Vendimi 09/02, Rikategorizohet pika e kalimit kufitar me Republikën e Maqedonisë “Stançiç” nga vendkalimi kufitar lokal në vendkalim kufitar rajonal për qëllime të komunikacionit ndërkombëtar, përkatësisht kalon në kategorinë A;
 - 1.9 Vendimi 10/02, Të iniciohet procedura për hartimin e politikave për vendosjen e regjimit të vizave në Republikën e Kosovës.
3. Vendimet nga mbledhja e tretë e Qeverisë së Kosovës, mbajtur me 9 Mars 2011:
 - 2.1 Vendimi 01/03, Qeveria e Republikës së Kosovës në cilësinë e ushtruesit të ligjshëm të të drejtave të aksionarit të Republikës së Kosovës, në Ndërmarrjen Publike PTK, vendos të kërkojë nga PTK dhe Bordi i saj i drejtorëve që të deklarojë dhe të paguajë një dividendë “Dividenta” për aksionarin në shumën prej 40,000.000.00 (dyzetë milionë) euro;
 - 2.2 Vendimi 02/03, Të ofrohen për tenderim dhe shitje 75% të aksioneve të Ndërmarrjes Publike, SH.A;
 - 2.3 Vendimi 03/03, Aprovohet, me ndryshime, Plani i Veprimit për dhjetë Prioritetet Kyçe të Qeverisë në fushën e Integritimit Evropian;
 - 2.4 Vendimi 04/03, Autorizohet Ministri i Financave që të aprovojë transfero nga programi shpenzime të paparashikuara për shumat individuale të kërkuara deri në vlerë prej 20,000.00 (njëzet mijë) euro;
 - 2.5 Vendimi 05/03, Ndahen mjete financiare në vlerë prej 5,000.00 (pesëmijë) euro për familjen e fëmijës së vvarë, Leutrim Musliu nga fshati Uglar, Komuna e Gjilanit.

4. Vendimet nga mbledhja e katërt e Qeverisë së Kosovës, mbajtur me 11 Mars 2011:
 - 3.1 Vendimi 01/04, Miratohet Projektligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011;
 - 3.2 Vendimi 02/04, Ndryshohet dhe Plotësohet Vendimi i Qeverisë, Nr. 08/39 i datës 08.10.2008 për themelimin e Komisionit Qeveritar për privatizimin e Kompanisë Kosovare për Distributum dhe Furnizim me Energji Elektrike.
5. Vendimet nga mbledhja e pestë e Qeverisë së Kosovës, mbajtur me 16 Mars 2011:
 - 4.1 Vendimi 01/05, Miratohet Plan i Vjetor i Punës së Qeverisë për vitin 2011;
 - 4.2 Vendimi 02/05, Miratohet me ndryshime Strategjia Legjislative për vitin 2011;
 - 4.3 Vendimi 03/05, Miratohet me ndryshime Plan i Veprimit për Partneritet Evropian 2011;
 - 4.4 Vendimi 04/05, Miratohet me ndryshime Rregullorja për fushat e përgjegjësit administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe të ministrave
6. Vendimet nga mbledhja e gjashtë e Qeverisë së Kosovës, mbajtur me 23 Mars 2011:
 - 5.1 Vendimi 02/06, Miratohet Projektligji për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-010 për Noterinë në Kosovë;
 - 5.2 Vendimi 03/06, Miratohet Rregullorja për Shërbimin e Komunikimit Qeveritar me Publikun;
 - 5.3 Vendimi 04/06, Miratohet Projektligjin për Gjendjen Civile.
7. Vendimet nga mbledhja e shtatë e Qeverisë së Kosovës, mbajtur me 30 Mars 2011:
 - 6.1 Vendimi 02/07, Miratohet Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-069 për Akreditim;
 - 6.2 Vendimi 03/07, Miratohet Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.02/L-123 për Shoqëritë Tregtare;
 - 6.3 Vendimi 04/07, Miratohet Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2004/18 për Tregtinë e Brendshme;
 - 6.4 Vendimi 05/07, Miratohet Projektligji për Shërbimet e Sigurisë Private;
 - 6.5 Vendimi 06/07, Miratohet Projektligji për Bashkëpunim Ndër – komunal dhe Partneritete;
 - 6.6 Vendimi 07/07, Miratohet Raporti Vjetor Financiar për vitin 2010;
 - 6.7 Vendimi 08/07, Themelohet Bordi për Menaxhim me Pyje në kuadër të Kabinetit të MBPZ, për të zbatuar politikën, strategjitë dhe planin e veprimit të aprovuara nga Qeveria e Kosovës.;
 - 6.8 Vendimi 09/07, Aprovohet Raporti për vlerësimin e përshtatshmërisë së sistemit të financimit për komuna për vitin 2010;
 - 6.9 Vendimi 10/07, Qeveria e Kosovës merr qëndrim që kërkesa e Ministrisë së Punëve të Brendshme për shfrytëzimin e objektit të ish – “Jugobankës” në Mitrovicë, të bëhet pas kryerjes së procedurave të nevojshme në pajtim me Ligjin në fuqi.

gap monitor

i vendimeve të Qeverisë së Kosovës

Rr. Nëna Terezë 41/29
10000 Prishtinë, Kosovë
+381 38 224 145
monitor@institutigap.org
www.institutigap.org

“GAP Monitor” është projekt i Institutit për Studime të Avancuara GAP në të cilin monitorohen vendimet e Qeverisë së Kosovës. Projekti i “GAP Monitor” ka filluar në janar të 2009, ku përmes publikimeve të përmuqshme Instituti GAP i ofron publikut informata dhe analiza më të thella për të gjitha vendimet e Qeverisë së Kosovës. Tani, projektit të “GAP Monitor” është shtuar edhe faqja e re në internet, e cila na mundëson interaktivitet më të madh me lexuesit si dhe mundësinë për të publikuar lajme dhe analiza në kohë më të shpejtë.

INSTITUTI PËR STUDIME TË AVANCUARA



Instituti GAP është Think Tank kosovar, që punon në ngushtimin e hendekut në mes qeverisjes dhe qytetarëve të Kosovës, në shërbim të avancimit të shoqërisë kosovare.

Të gjitha raportet për vendimet e Qeverisë mund të gjenden edhe në portalin e GAP Monitor në internet www.gapmonitor.org

Instituti për Studime të Avancuara GAP
përkrahet nga:

Projekti i GAP Monitor
përkrahet nga:



Opinionet e shprehura në këtë dokument janë ato të Institutit GAP dhe jo medoemos reflektojnë pikëpamjet e donatorëve të këtij projekti.